



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 18, datë 12.07.2019

PËR

RISHIKIMIN E KUSHTEVE DHE SHTYRJEN E AFATIT TË LEJES EKZISTUESE PËR
OBJEKTIN: “NDËRTIMI I HIDROCENTRALEVE DARSIS 1 DHE DARSIS 2”, NË
PËRROIN E DARSIT, BASHKIA KLOS”

Në mbështetje të Neneve 27, 28 dhe 48, të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit “Henz Energy” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e rishikimit të kushteve dhe shtyrjen e afatit të lejes ekzistuese për objektin: “Ndërtimi i Hidrocentraleve DARSIS 1 dhe DARSIS 2”, në përroin e Darsit, Bashkia Klos”, me subjekt zhvillues shoqërinë “Henz Energy” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

